



**BASHKIA E TIRANËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 39, datë 23.09.2015**

**Për**

**“CAKTIMIN E NUMRIT TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË KËSHILLIN E  
BASHKISË TIRANË DHE EMËRTIMIN E TYRE”**

Në mbështetje të nenit 32, gërma “a”, e Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe nenit 23 të vendimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë nr. 217, datë 14.11.2000 “Rregullore e funksionimit të Këshillit Bashkiak”, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Tiranë dhe kryetarëve të grupeve të këshilltarëve, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

I. Komisionet e Këshillit të Bashkisë Tiranë dhe emërtimet e tyre janë si më poshtë:

1. Komisioni për Cështjet Ligjore;
2. Komisioni i Financës, Ekonomisë dhe Nxitjes së Sipërmarrjes
3. Komisioni i Shëndetësisë, Higjenës dhe Veterinarisë
4. Komisioni i Strehimit dhe Cështjeve Sociale;
5. Komisioni për Barazinë Gjinore dhe sipërmarrjen e Gruas;
6. Komisioni i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë;
7. Komisioni i Shërbimeve Publike;
8. Komisioni për Planifikimin, Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Territorit dhe Mjedisit;
9. Komisioni i Arsimit dhe i Sporteve;
10. Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ushqimit;
11. Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë;
12. Komisioni i Kontrollit Financiar;
13. Komisioni për Sigurinë Publike dhe Emergjencat Civile;
14. Komisioni i Mandateve;
15. Komisioni i Kulturës, turizmit dhe figurave të shquara të qytetit;
16. Komisioni për Politikat Rinore.

II. Vendimet nr. 6, datë 10.02.2004 dhe nr. 7, datë 12.10.2011 të Këshillit Bashkiak Tiranë, shfuqizohen.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**ALDRIN DALIPI**